

REGULLORE  
E LOJËS SË FATIT PROMOCIONALE  
**"GIVEAWAY"**

Sipas kërkesave të Ligjit nr. 155/2015 "Per Lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 196/2017 "Për Përcaktimin e Mënyrave, Formave, Kriteve dhe Rregullave për Organizimin e Lojërave të Fatit Promocionale

**Neni 1**  
**ORGANIZATORI I LOJËS PROMOCIONALE**

1. Organizatori i Lojës Promocionale "GIVEAWAY!" është: Shoqëria "Neptun" sh.p.k (referuar këtu më poshtë si "Neptun"), person juridik shqiptar, regjistruar me NIPT K12222001B, me seli ne adresën: Selia Brunos Space, Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Përballë Qendrës Tregtare TEG, Lundër, Shqiperi, rregullisht i përfaqësuar në këtë kontratë nga Z. Alexandros Kosenas. Neptun është i regjistruar si subjekt tatimpagues në Drejtorinë Rajonale Tatimore ne Tiranë.

2. Me anë të kësaj Loje Promocionale, Neptun ka për qëllim të promovojë produktet në të gjithë kanalet online për të gjithë klientët dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2**  
**AFATI**

1. Loja Promocionale do të zhvillohet në një periudhë kohore prej rreth 9 (nente) muajsh kalendarike. Loja promocionale do të fillojë në datë 01.07.2025 dhe do të përfundojë në datën 31.03.2026 në orën 23:59.

2. Në një datë të caktuar të çdo muaji, datë e cila do të komunikohet në profilin zyrtar te Neptuun ne Instagram dhe faqen e web-it do të hidhet shorteu për përzgjedhjen e fituesve mujore të lojës.

### **Neni 3**

## **MEKANIZMI I LOJËS PROMOCIONALE**

- 1.** Neptun ka në treg një gamë të gjerë produktesh në të gjithë rrjetin e dyqaneve që shtrihet në të gjithë qytetet e vendit.
  
- 2.** Personat që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë Lojë Promocionale duhet të ndjekin hapat e mëposhtme, pasi të njoftohen me postimin përkatës i cili do të qëndrojë 7-10 ditë:
  - a)** te bëjnë "follow" faqes së Instagram të Neptun Albania;
  - b)** te bëjnë "follow" faqes së Instagram të markave specifike ne rastet kur aplikohet sipas produktit që do të postohen (Dyson, Beko, Razer, Bose, Xiaomi, Bosch, SEB, Philips, Fuego, Whirlpool)
  - c)** Te bëjnë "like" postit specifik
  - d)** Te komentojnë dhe/ose tag një shoqe/shoqe.
  
- 3.** Në momentin që mbyllet Loja Promocionale, automatikisht do të gjenerohet lista e të gjithë pjesëmarrësve që kanë ndjekur hapat e mësipërme.
  
- 4.** Lista e pjesëmarrësve në shorte do të ngarkohet në zgjidhjen softwarike Simpliers që mundëson përzgjedhjen rastësore të fituesit.
  
- 5.** Fituesi për të tërhequr çmimin, duhet të paraqitet në zyrat qendrore te Neptun ose në çdo pikë shitje Neptun nëse i komunikohet nga Neptun, ditën e caktuar i pajisur, me mjet identifikimi.
  
- 6.** Shorteu dhe shpallja e numrave fitues do të zhvillohet në praninë e një përfaqësuesi të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit pranë Ministrisë së Financave dhe përfaqësuesve të Degës Rajonale të Njesise se Tatimpaguesve Tiranë të cilët do të njoftohen nga Neptun 20 (njëzet) ditë përpara sipas kërkesave të VKM Nr.196/2017 si edhe në prani të Komisionit të Lojës së Fatit Promocionale të ngritur me këtë rast nga ana e Neptun Albania sh.p.k.
  
- 7.** Shorteu dhe shpallja e numrave fitues do të bëhet pranë zyrave qendrore të Neptun sh.pk me vendndodhje në: Selia Brunos Space, Rruga Nacionale Tirane- Elbasan, Përballë Qendrës Tregtare TEG, Lundër, Tirane, Albania.
  
- 8.** Numri i personave që parashikohet të marrin pjesë në këtë Lojë Promocionale, mund të jetë rreth 50.000 (pesëdhjetë mijë).

## **NENI 4**

### **PJESËMARRJA**

1. Pjesëmarrës në këtë Lojë Fati Promocionale kanë të drejtë të jenë:

Të gjithë personat të cilët ndjekin hapat e mëposhtme, pasi të njoftohen me postimin përkatës i cili do të qëndrojë 7-10 ditë:

- e) të bëjnë "follow" faqes së Instagram të Neptun Albania;
- f) të bëjnë "follow" faqes së Instagram të markave specifike ne rastet kur aplikohet sipas produktit që do te postohet (Dyson, Beko, Razer, Bose, Xiaomi, Bosch, SEB, Philips, Fuego, Whirlpool);
- g) Të bëjnë "like" postit specifik;
- h) Të komentojnë dhe/ose tag një shoqe/shoqe.

2. Pjesëmarrësi i cili nuk ka ndjekur qoftë dhe një nga hapat mësipërm nuk mund të jetë fitues apo në listën e fituesve

3. Të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësinë të kontrollojnë fituesit ne web faqen e Neptun [www.neptun.al](http://www.neptun.al) ku do të publikohet kjo rregullore dhe informacion i përditësuar.

4. Të gjithë pjesëmarrësit kanë mundësinë të marrin informacion në çdo dyqan Neptun si edhe në numrin e telefonit +35544505050.

5. Pjesëmarrësit në Lojën Promocionale duhet të jenë mbi 18 vjeç. Nëse numri i përzgjedhur është në përdorim të një të mituri (nën 18 vjeç) atëherë cmimi do të tërhiqet prej prindit/kujdestarit ligjor. Neptun nuk do të promovojë pjesëmarrjen e personave të mitur.

6. Nuk mund të marrin pjesë në këtë Lojë Fati Promocionale:

**Stafi i lidhur ngushtësisht me Neptun SHPK**

## **Neni 5**

### **TERRITORI**

1. Loja promocionale "Giveaway" do të zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **Neni 6**

## CMIMET

1. Në përfundim të kohëzgjatjes së Lojës Promocionale, në datën e hedhjes së shortit final, i cili do të komunikohet ne faqen zyrtare te Neptun ne Instagram dhe ne faqen e web-it, do të shpallen në total 19 (nentembedhjte) fitues të cilët do të kenë mundësinë të përfitojne një nga cmimet si më poshtë:

Nr.	Çmimet (mujore)	Sasia	Vlera ne ALL me TVSH	Dita e hedhjes se shorteut
1	Razer Basilisk V3 Razer Barracuda X	1	15,480	15 Korrik 2025
2	Air Conditioner Beko	1	52,990	28 Korrik 2025
3	Smartwatch Redmi Watch 5 Active Midnight Black	1	4,990	12 Gusht 2025
4	Open Earbuds Bose	1	37,990	26 Gusht 2025
5	Dishwasher Bosch	1	69,990	16 Shtator 2025
6	Mobile Phone Xiaomi Redmi Note 14 4G 6/128 GB Midnight Black	1	23,990	30 Shtator 2025
7	Multicooker Tefal	1	19,690	14 Tetor 2025
8	Lumea Philips	1	93,990	18 Nentor 2025
9	Trimmer Philips	1	13,990	2 Dhjetor 2025
10	TV Fuego	1	51,990	16 Dhjetor 2025
11	Washing Machine Whirpool	1	62,990	30 Dhjetor 2025
12	Ekspres Dolce Gusto SEB	5	62,450	13 Janar 2026
13	Dyson Airwrap	1	68,890	27 Janar 2026
14	Airfyrer Philips	1	34,990	17 Shkurt 2026
15	Stick Rowenta SEB	1	17,690	17 Mars 2026
---	<b>Çmimi Total</b>	<b>19</b>	<b>632,100 ALL me TVSH</b>	

2. Në total Neptun do të ofrojë 19 çmime përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Loje Promocionale.

3. Cmimet e Lojës së Fatit Promocionale janë të patransferueshme pavarësisht çdo rrethane apo situatë.

4. Neptun mund të refuzojë dhënien e çmimit në rast se ajo konstaton se nuk janë

respektuar kushtet e kësaj Rregulloreje, apo në rast se fituesit rezultojnë të tillë si rezultat! ndonjë parregullsie apo mashtrimi.

### **Neni 7**

#### **NJOFTIMI I FITUESVE DHE TERHEQJA E CMIMIT**

- 1.** Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes fituesi do të kontaktohet nga faqia Zyrtare e Instagram Neptun tek llogaria e tij Instagram ku është shpallur fitues me nje mesazh. Fituesit do të kontaktohen edhe me telefon nga agjentët e Call Center te Neptun ku do të kërkohen edhe detajet identifikuese.
- 2.** Për të tërhequr çmimin, fituesit duhet të paraqiten në zyrat qendrore të Neptun me adrese: Selia Brunos Space, Rruga Nationale Tiranë-Elbasan, Përballë Qendrës Tregtare TEG, Lundër, Shqipëri. Në momentin e paraqitjes për tërheqjen e cmimit, fituesit do t'ju kërkohet të japin të dhënat e tyre të cilat janë: Emër, Atësi, Mbiemër, Datëlindje, kopje e kartës së identitetit dhe/ose i pasaportës si dhe adresa e banimit.
- 3.** Nëse fituesi nuk paraqitet për të tërhequr cmimin brenda 14 ditëve nga momenti i njoftimit, Neptun do të kontaktojë fituesin nëpërmjet telefonit për ti rikujtuar cmimin që ka fituar nga Loja Promocionale. Nëse fituesi nuk përgjigjet ri-tentohet përsëri pas 7 ditësh. Ky proces do të përsëritet dhe 2 herë të tjera, dhe nëse nuk ka rezultat, cmimi i jepet fituesit vijues te listuar ne rradhe ne daten kur eshte hedhur shorteu pavaresisht vleres se cmimit. E njejta gje ndodh edhe ne rast se per cfaredolloj arsye fituesi i perzgjedhur nuk pranon dhe/ose refuzon te terheqe cmimin e fituar.

### **Neni 8**

#### **TË DHËNAT E PJESËMARRËSVE**

- 1.** Cdo pjesëmarrës në këtë Lojë Fati Promocionale pranon shprehimisht se Neptun mund të përpunojë të dhënat e tyre personale, të kërkuara sipas kësaj Rregulloreje, për qëllime të kësaj Lojë Fati Promocionale dhe për cdo qëllim tjetër të ligjshëm të Neptun në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887/2008, "Per Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Të gjitha të dhënat personale lidhur me fituesit dhe të dhënat për mënyrën e organizimit të Lojës së Fatit Promocionale do të ruhen për një periudhe jo më pak se 6 vjet sipas kërkesave të VKM nr. 168/2017.

### **Neni 9**

#### **TAKSA DHE TATIMET**

1. Fituesi nuk do të jetë subjekt detyrimesh, tarifash apo garancish që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çmimin përveç atyre të cilat mund të kerkohen detyrimisht për fituesin nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 10**

#### **PUBLICITETI**

1. Komunikimi i Lojës Promocionale do të bëhet nëpërmjet profilit zyrtar të Neptun në Instagram dhe në faqen e web-it.

2. Me pranimin e cmimit, fituesit kanë dhënë miratimin që emri dhe imazhi i tyre të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Neptun Shqiper [www.neptun.al](http://www.neptun.al) dhe në faqet zyrtare që Neptun ka në rrjetet sociale si Facebook, Instagram, LinkedIn. Gjithashtu fituesit i japin Neptun të drejta të plota lidhur me përdorimin e të drejtave të imazhit të tyre në fotografitë, videot (ose cdo version të tyre që ka prezencën e tyre) të cilat do të shfaqen në publik në kuadrin e fushatave promovionale aktuale apo të ardhshme të Neptun sh.p.k.

#### **Neni 11**

#### **FORCA MADHORE**

1. Loja Promocionale mund të ndërpritet vetëm në rastin e rrethanave për të cilat Neptun nuk është përgjegjëse, dmth., që nuk mund parandalohen, riparohen apo shmangen dhe në rast të ndonjë urdhërimit sipas ligjeve në fuqi nga autoritetet shtetërore. Njoftimi për ndërprerjen edhe cdo njoftim tjetër i rëndësishëm në lidhje me Lojën e Fatit Promocionale, do të publikohet në <http://www.neptun.al>.

#### **Neni 12**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

1. Me pjesëmarrjen në këtë Lojë Promocionale pjesëmarrësit kanë dhënë miratimin e tyre duke pranuar automatikisht rregullat dhe mekanizmin e Lojës Promocionale.

#### **Neni 13**

#### **TE NDRYSHME**

1. Rregullorja e Lojes Promocionale do të publikohet edhe në faqen në internet të Neptun, <http://www.Neptun.al>. Informacioni mbi Lojen Promocionale mund të merret gjithashtu prej Shërbimit për Kujdesin e Klientit duke telefonuar në numrin +35544505050 për te gjithë klientët.

Kjo Loje Fati Promocionale organizohet sipas Autorizimit nr. \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_\_ te Autoritetit te Mbikqyrjes se Lojrave te Fatit.

Tiranë, më \_\_\_\_\_